



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2018:067664

Datë: 23.10.2019

Numri i dokumentit: 00597926

P.nr.813/18

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË – Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Mentor Bajraktari, me procesmbajtësen Mandushe Doli – sekretare juridike pranë kësaj gjykate, në lëndën penale kundër të akuzuarit G.Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore–Departamenti përgjithshëm, me numër PP.1623/2018, të datës 15.11.2018, në seancën publike të shqyrtimit fillestar, të mbajtur **me datë 22.10.2019**, në prezencën e Prokurorit të shtetit Bajram Kryeziu si dhe të akuzuarit, në të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datën 23.10.2019 e përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari:

G.Z., nga i ati S., e ëma Z., e gjinisë B., data e lindjes..., në Gjakovë, ku edhe tani jeton, i martuar, baba i 8 (tetë) fëmijëve, ka të kryer shkollën fillore, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, shqiptar-shtetas i Republikës së Kosovës, numër personal...

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse ndërmjet datës së pavërtetuar e gjerë më datën 02.08.2018, në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim që vetës ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me nenin 61 par.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Kosovës ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që pas kontrollit është konstatuar se i akuzuari përmes kabllor 2x16 mm është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim është penguar regjistrimi i saktë energjisë elektrike të shpenzuar, me ç'rast të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën prej 92.62 Euro.

Me këto veprime ka kryer veprën penale: vjedhje e shërbimeve 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në kuptim të neneve 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, të akuzuarit i shqipton:

D Ë N I M I N M E K U S H T

Duke ia vërtetuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 60 (gjashtëdhjetë) ditëve, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda afatit të verifikimit prej 1 (një) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen vepër tjetër penale.

Detyrohet i akuzuari G.(S.)Z. nga Gjakova, që të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, t'ia kompensoi në emër të dëmit të shkaktuar-kërkesën pasurore-juridike në shumë prej 92.96 Euro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcenim të përmbarimit.

I akuzuari lirohet nga shpenzimet e procedurës penale dhe të njëjtat bien në llogari të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Gjakovë-Departamenti i Përgjithshëm, pranë kësaj gjykate ka ngritur aktakuzën PP.1623/2018, të datës 15.11.2018, kundër të akuzuarit G.Z. nga Gjakova, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së.

Prokurori i shtetit: Bajram Kryeziu, gjatë shqyrtimit fillestar pas leximit të aktakuzës ka bërë rikualifikimin e veprës penale duke deklaruar se: bëjë rikualifikimin e veprës penale vjedhje shërbimeve komunale nga neni 320 të KPRK-së, duke marrë parasysh se nga data 14.Prill 2019 ka hyrë në fuqi Kodi i Ri Penal, ashtu që duke aplikuar nenin 3 par.2 të KPRK-së, për realizimin e ligjit të favorshëm pasi që sipas nenit 320 të ish KPRK-së, për veprën penale për të cilën ngarkohet i akuzuari parashihet dënimi komulativ pra dënim me gjobë dhe me burgim deri në 3 vite, ndërsa sipas Kodit të Ri Penal, vepra penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, është e dënueshme me dënim me gjobë ose me burgim pra dënueshmëria për këtë vepër është e përvaktuar në mënyrë alternative, dhe Kodi i Ri Penal dhe vepra penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së, është më i favorshëm për të pandehurin, prandaj edhe bëjë rikualifikimin e veprës penale, vepra penale e shërbimeve komunale nga neni 320 të ish KPRK-së (Kodi I Vjetër), në veprën penale vjedhje e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së (Kodi I Ri), ndërsa pjesa tjetër mbetet e pa ndryshuar deklaroi se nuk e kundërshtoj pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që i njëjti pranimin e fajësisë e bën me vetëdije dhe me vullnetin e plotë pa presion, i njëjti e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë po ashtu pranimi i fajësisë mbështetet edhe provat dhe faktet që janë bashkangjitur aktakuzave. Gjatë shqyrtimit fillestar Prokurori i shtetit Bajram Kryeziu, ka qëndruar në tërësi pranë aktakuzës së rikualifikuar kundër të akuzuarit G.Z., andaj ka propozuar që i njëjti të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari G.Z., gjatë shqyrtimit fillestar ka deklaruar se pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës dhe ka shtuar se është penduar për këtë veprim dhe këtë e ka bërë për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike pasi që nuk kam mundur ti lë fëmijët në terr, andaj premtoi gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprime të kësilla.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Në tërësi u vërtetua se i akuzuari G.Z., ndërmjet datës së pavërtetuar e gjerë më datën 02.08.2018, në shtëpinë e tij në Gjakovë, me qëllim që vetës ti sjellë përfitim pasuror në mënyrë të kundërligjshme, në kundërshtim me nenin 61 par.1 të Ligjit për Energjinë Elektrike të Kosovës ka shfrytëzuar energjinë elektrike në atë mënyrë që pas kontrollit është konstatuar se i akuzuari përmes kabllor 2x16 mm është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me këtë veprim është penguar regjistrimi i saktë energjisë elektrike të shpenzuar, me ç'rast të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën prej 92.62 Euro.

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga i akuzuari, i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajësinë, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga i akuzuari është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-së. Gjatë pranimi të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatoi se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit, pranimi është bërë vullnetarisht nga i akuzuari, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjet që përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga Prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike dhe se nuk ekziston asnjë nga rrethanat e parapara në nenin 253 paragrafët 1 dhe 2 të KPP-së, për pushimin e procedurës penale përkatësisht hedhjen e aktakuzës.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 të KPRK-së dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarin të shpall fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit, e më parë duke vërtetuar përgjegjësinë penale juridike të tij.

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, prej rrethanave lehtësuese gjykata ka vlerësuar rrethanat personale të akuzuarit: është baba i 8 (tetë) fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, përfitues i ndihmës sociale, mbajtës i familjes prej 7 anëtarësh, të ardhurat i siguron vetëm nga ndihma sociale, në gjykim ka pasur qëndrim tejet korrekt, pranimin e fajësisë në shqyrtimin fillestar, pendimin e tij duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të këtyra, do të jetë më i kujdesshëm, si dhe faktin që më parë nuk ka qenë i dënuar. Kështu që duke mos gjetur rrethana rënduese për të akuzuarin gjykata ka ardhur në përfundim se me dënimin e shqiptuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 dhe 47 i KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedon i akuzuari dhe se dënimi i shqiptuar do të ndikoj në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe do të bëjë rehabilitimin e tij, do të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe do të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Në bazë të nenit 463 paragrafi 2 lidhur me paragrafin 1 të KPP-së, gjykata ka vendosur që i akuzuari G. (S.) Z. nga Gjakova, që të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë, t'ia kompensoi të dëmtuarës K.-Distrikti në Gjakovë në emër të dëmit të shkaktuar-kërkesën pasurore-juridike në shumë prej 92.96 Euro, në afat prej 1 (një) muaji nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarimit.

Vendimi mbi lirim nga shpenzimet e procedurës penale për të akuzuarën është marr konform nenit 453 par.4 të KPP-së, për faktin se gjykata konsideron se me pagimin e shpenzimeve do të rrezikohet gjendja materiale e të akuzuarës pasi që është e gjendjes shumë të dobët ekonomike, është përfitues i ndihmës sociale, ku i akuzuari gjatë shqyrtimit fillestar, gjykatës ia ka dorëzuar një kopje të kartelës për ndihmë sociale përmes të cilës vërtetohet se është përfitues i ndihmës sociale pranë Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë.

Me sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi konform nenit 365 të KPP-së.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË
- Departamenti i përgjithshëm -
P.nr.813/18, me datë 22.10.2019

Procesmbajtësja,
Mandushe Doli

Gjyqtari i vetëm gjykues,
Mentor Bajraktari

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese, në afat prej 15 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.